

**SHTRESIMET NARRATIVE DHE VEÇORITË NË DISA ROMANE TË PETRO  
MARKOS, ERNEST HEMINGWAY-IT DHE ERICH MARIA REMARQUE**

**Ermira YMERAJ**

Universiteti i Shkodrës „Luigj Gurakuqi“, Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe  
miraymeraj@yahoo.com

**Emine SHABANI**

Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe  
emine.shabani@unite.edu.mk

**UDC 82-3.09**  
*Conference paper*

**Abstract**

Three writers, humanist contemporaries, who took part in the war in Spain and other countries in the 30-ties and 40-ties of the 20-th century, the memories from these wars they inked in paper that took the form of their extraordinary novels. These works represent the core of their success and the subject-matter of the study of many contemporary critics. Out of many stylistic and aesthetic analyses that were undertaken. We have chosen as the subject matter of my study the narrative shifts and peculiarities in the novels *One Night and two Dawns, A farewell to Arms and All Quiet on the Western Front*.

The subject matter of our study focuses on the legitimacy of the structure of literary works, drawing a parallel with the extra textual relations like the historical, political circumstances and the individual and societal mentality at the time of creation of these works. Our study, as far as the internal research, will focus on three aspects: the functional plain, the narrative plain, and the plain of action. The chronology of our study is based on the narrative analysis, the structure of deep literary, scientific, philosophical knowledge, the linguistic structure and the figurative meaning of it, as well as the common peculiarities, influences, with other works, the writing style of the period in which the authors lived and wrote as well as the individual style of theirs.

**Key words:** *Narration, gradual focalization, the focus of narration, war, life, fear, survival, etc.*

## Përmbledhje

Tre shkrimtarë, bashkëkohës humanistë, të cilët morën pjesë në luftën e Spanjës dhe luftëra tjera në vitet e 30-ta dhe 40-të të shekullit të XX, kujtimet nga këto luftëra i përjetësuan në romanet e tyre të jashtëzakonshme. Këto vepra përfaqësojnë thelbin e suksesit të tyre dhe u bënë objekt studimi i shumë kritikëve bashkëkohorë. Nga shumë analiza stilistike dhe estetike që janë ndërmarrë, ne kemi zgjedhur si lëndë të studimit tonë shtresimet narrative dhe veçoritë në romanet *Një Natë dhe dy Dy Agime, Lamtumirë në Armë dhe Asgjë e re në frontin Perëndimor*.

Çështja e studimit tonë përqendrohet në legjitimitetin e strukturës së veprave letrare, duke krijuar një paralele me marrëdhëniet tekstuale si rrethanat historike, politike dhe mentalitetin individual dhe shoqëror në kohën e krijimit të këtyre veprave. Studimi ynë, sa i përket hulumtimit të brendshëm, do të përqendrohet në tre aspekte: rrafshi funksional, rrafshimi narrativ dhe rrafshi i veprimit. Kronologjia e studimit bazohet në analizën narrative, strukturën e njohurive të thella letrare, shkencore, filozofike, strukturën gjuhësore dhe kuptimin figurativ të saj, si dhe veçoritë e përbashkëta, ndikimet, me vepra të tjera, stilin e periudhës në të cilën jetuan dhe vepruan autorët, si dhe stilin individual të tyre.

**Fjalët kyçe:** *Narracioni, fokalizimi gradual, fokusi i transmetimit, lufta, jeta, frika, mbijetesa etj.*

Hemingway, ishte intelektuali, gazetari dhe vullnetari në disa luftëra; në atë të Spanjës, italo-austriake. Petro Marko vullnetar, gazetar, gjithashtu pjesëmarrës në luftën e Spanjës, e partizanëve italianë kundër fashistëve, e nazistëve dhe të partizanëve shqiptarë kundër fashistëve. Ndërsa Remarque, ishte një tetëmbëdhjetëvjeçar që sapo kishte mbaruar shkollën e mesme bashkë me gjithë shokët e tij të klasës. Përvojën e tij si vullnetar në luftë Hemingway përjetësoi në romanet *Për kë bie kambana* dhe *Lamtumirë armë*, ndërsa Petro Marko te *Hasta la vista, Një natë dhe dy agime, Një emër në katër rrugë* etj. Erich Maria Remarque në romanin *Asgjë e re në frontin perëndimor, etj.* Lufta preku gjithë letërsinë e shekullit XX, është një numër i madh romanesh që kanë temë luftën dhe humbjen e etikës së saj:

Tolstoj në veprën *Ligji i dashurisë dhe ligji i urrejtjes* thotë: Situata e të shtypurve nuk duhet të krahasohet me kufizimet e përdorura drejtpërdrejt nga më të fortët tek më të dobëtit, ose nga një numër më i madh në një më të vogël. Këtu, me të vërtetë, është pakica që shtyp

shumicën, në sajë të një gënjeshtre të krijuar më parë nga njerëz të mençur, në bazë të të cilëve njerëzit e plaçkisnin njëri-tjetrin (Étienne de La Boétie:17).

Ndërsa për filozofin Max Weber, *fuqia* është jolegjitime dhe ajo nuk ka asgjë heroike në vetevete, edhe pse difuze ajo gjithmonë përfundon me qeverisje. Pushteti i përqëndruar, i centralizuar dhe me tradita ose me rregulla të formalizuara me fuqinë e urdhëresave që nënkupton dëgjueshmëri të një numri të madh të njerëzve. Ai e njeh mirë fytyrën e çdo pushteti. Udhëheqës të mëdhenj si Bonnaparta dhe Bismarck-u, çuan në vdekje një numër të madh njerëzish, për shkak të qëllimeve në të cilat është e pamundur të gjendet kuptimi më i lartë (Weber 1999:19).

Në veprën *Asgjë e re në Frontin Perëndimor*, gjithçka fillon me të kundërtën e qetësisë, me zhurmën e armëve, bombardimeve! Në episodin e dytë kemi një digresion retrospektiv të shokëve të klasës së Baumerit, është dita e fundit e shkollës dhe këta maturantë të diplomuar duhet të nisen në luftë pas pak ditësh. Fjalimin e fundit të kujdestarit të tyre e dëgjojnë të gjithë përveç ëndrrimtarit Baumer, ai pikturonte zogun që po rinte në parmak të dritares. Siç e shohim kjo skenë do ta përmbyllë edhe romanin dhe njëkohësisht dhe jetën e personazhit të kësaj vepre, ky kompozicion unazor ka ndërmjet një mori ngjarjesh që rrëfejnë për absurditetin e të luftuarit dhe luftës si dukuria më e gabuar njerëzore.

Shumë filozofë e dijetarë kanë thyer shpatat që nga antika e deri sot mbi konceptin e luftës. Ata mund t'i ndajmë në mendimtarë që e shohin luftën si të domosdoshme deri tek ata që e shohin si të patjetërsueshme (natyrisht këta të fundit bëjnë pjesë në dosjet e psikiatërve të njohur botërorë) dhe ata që janë kategorik kundër çdo lloj lufte, si Boese, Ghandi, Tolstoi, David Hjumi, sigurisht edhe Jezu Krishti të cilin duhet përmendur të parin, etj.

Një grup të rinjsh, të gjithë 18 vjeçarë, Paul Baumeri, Joze Behm, (që do të studionte teologji), Albert Kropp (që do të studionte drejtësi), Friedrich Muller (që do të studionte të përgjithshmen), Franz Kamerich-u, (që donte të bëhej pylltar), Peter Leer (që donte të udhëtonte dhe të shijonte jetën), Tjaden-i (hekurpunues), Haie Westus (një njeri i mirë për ta pasur në krah), Detering (që nuk mendonte për asgjë përveç kuajve të tij).

Autori që sipas Harold Bloom nuk ishte një intelektual, por arriti që ta përjetësojë pjesëmarrjen dhe tmerret që ka lufta, në romanin e tij dhe arriti gjithashtu që romani i tij të bëhej, i suksesshëm në Europë e botë. Protagonisti Paul Baumer pas të cilit qëndron vet autori ka një epigram kuptimplotë në fillim të romanit: *After all the lies told by people like*

*Remarque, we now bring to you the experience of a soldier who took part in the war, of which you will say at once: that is what it was really like.*<sup>1</sup>

Dhe kjo kishte ndodhur në Luftën e Parë Botërore. Ky libër nuk do të jetë as një akuzë, as rrëfim, dhe më së paku një aventurë, sepse vdekja nuk është një aventurë për ata që qëndrojnë ballë për ballë me të. Ai do të përpiqet thjesht të tregojë për një brez njerëzish të cilët, megjithëse mund të kenë ikur nga predhat e saj, u shkatërruan nga vet lufta. (Remarque: 4). Përveç netëve pa gjumë, mungesës së ushqimit, ndodhin fatkeqësitë njëra pas tjetrës, së pari plagoset Kamerich-u, të cilit i amputohet këmba dhe pas ca ditësh vdes në katedralen e shndërruar në spital.

Në betejat tjera plagosen dhe vdesin të gjithë. Të gjithë shokët e klasës mbeten në luftë, ata nuk ishin veçse 19 vjeç e gjysmë ose 20. Te romanet shqiptare me tema lufte, kemi autorin Petro Marko me Një natë dhe dy agime, Hasta la vista dhe Një emër në katër rrugë, etj. Tek Një natë dhe dy agime që vlerësohet nga studiuesja Floresha Dado, si romani që rrëfen dhimbjet dhe vuajtjet njerëzore në ishullin e shkretët të Ustikës. Andrea Bora është protagonist që deri diku bart karakteristikat e autorit.

Ai është një djalë i ri antifashist, patriot dhe idealist për të ardhmen e atdheut të tij dhe të gjitha vendeve të përfshira në luftë, ai mbi të gjitha është human e kozmopolit. Për shkak të rezistencës ndaj pushutesit, ai gjendet para gjykatësit të huaj në vendlindjen e tij, Andrea është akuzuar për cënimin e integritetit të shtetit! Ai ka një përgjigje interesante dhe kuptimplotë:

Unë bëj politikë, ndaj edhe jam i akuzuar për faje politike... Dua të më deklaroni këtu cilën drejtësi mbron: të shtetit italian apo të shtetit shqiptar...

Pas përkthyesit, prokurori, i inatosur: - Zoti kryetar, zoti gjykatës. Këtu kemi të bëjmë me një anarkist... të rafinuar... nuk duhet lejuar të shkelë parimet e drejtësisë sonë.

Kryetari ia bëri me dorë të ulej. Prokurori ishte nxirë më tepër nga zemërimi (Marko, 2002:92).

Te romanet e Markos, diskursi është virtytë nxitës, here-herë personal dhe emocional, me trajta metaforike. e gjithë vepra e Markos mund të quhet një sistem, të gjitha librat e tij janë sisteme integrale, që rrëfejnë ose shfaqin nga sfera të ndryshme të anës së tyre. Ato komunikojnë me njëra tjetrën, lidhen me urat ideologjike, tematike, diskursive dhe transponimin e personazheve pak a shumë të ngjashëm, duke ua ndërruar emrat, ngjarjet, në

---

<sup>1</sup> Shënim, Mbi të gjitha gënjeshtat që i thonë njerëzit sikurse edhe Remarque, tash ju sjellim një përvojë të një ushtari që ka marrë pjesë në luftë, për të cilin menjëherë do të thoni: kjo është ajo që me të vërtetë ka ndodhur!

një fytyrë/pamje ose dritë tjetër (Gori Gjinleka, Andrea Bora, Leka etj). Ai e strukturon tekstin mbi parimin e kodit tematik, secili fund bëhet një fillim i ri. Tema artikullohet herë si personale, herë nacionale e herë universale. Te Hemingway, ai është ironik, shpotitës, me fjali të shkurtra, të tërthorta, herë-herë me diskurs idiomatik, ironizon kotësinë e luftës, vdekjen, vetëvrasjen, ankthin, si rezultat i marrëzisë së njerëzve që shpikën atë.

Logjikë e pasqyrimin krijues të tij, janë zhvendosjet, llojllojshmëria e eksponimit të elementeve, leximi vertikal dhe i kryqëzuar. Remarque rrëfen për një klasë të rinjsh që u nisën në luftë me entuziazëm rinor dhe me frymë atdhedashurie. Baumeri personazhi kryesor, një djalë simpatik dhe shumë i ndjeshëm e tejkalon intrigën e provës. Edhe pse i ri ai ka një shpirt të fuqishëm dhe i papërkulur, madje edhe kur shokët vdesin para syve të tij. Kjo dramë e përjetuar në lulen e rinisë, ndjell keqardhje edhe për ushtarin e ri francez që ai e vret, si formë vetmbrojtje, për të cilin do të qajë dhe do ndjejë empati, akoma më shumë kur i lexon dokumentat, Gerard Duval kompozitor!

Ndërsa Goldman thotë se *“Gjenium e vërtetë e karakterizon fakti se, duke folur për vetveten, flet gjithashtu për botën dhe historinë dhe anasjelltas”* (Jefferson-Robey 2004:267). Intelktuali ka shpirt të gjerë dhe është moralisht i pavarur. Këta virtyte i gjejmë tek autorët e këtyre veprave. Këta i manifestojnë me figuracionet poetike e prozaike të romaneve në fjalë. Shekulli XX, shkroi histori të përgjakshme njerëzore me luftën e I dhe II Botërore, ndërsa në shek XXI kemi edhe atrofim të vlerave të genies njerëzore...

Autorët e romaneve të luftës e përshkruajnë veprimin e personazheve të tyre me forcë e konkretësi. Madje edhe nga gjërat e zakonshme krijojnë përshkrime dhe rrëfime të jashtëzakonshme. Te Hemingway, kjo shkrihet me mendjemprehtësinë e Henry-t kur gjendet i robëruar nga austriakët në kolonë bashkë me shokët tjerë të luftës. Ai sfidon rrezikun dhe ik nga kolona, hidhet në lum dhe del në anën tjetër të tij. Të vjen spontane ta lidhësh këtë mënyrë mendimi me njeriun e vetëdijësuar në një moment kritik që gjendet mes jetës e vdekjes. i vetëdijësuar për kotësinë e luftës dhe viktimitë e njerëzve që duan famë, lavdi e pasuri, e të cilët i përdorin qytetarët/popullin e tyre si figura shahu.

Këtë mendim e ka edhe Stanislaus Katczinsky, udhëheqësi i të rinjve në luftën me francezët. Ai u shpjegon këtyre të rinjve se e vetmja arsye pse po luftojmë është sepse kjo luftë i hyn në punë dikujt, gjeneralëve dhe këtë e bëjnë për famë ! tek këto fakte dhe kushte, këto institucione historike u dhanë lëndë dhe ngjyrë romaneve të tre e më shumë autorëve të cilët qenë të detyruar ose shkuan vullnetarisht në luftë.

Në këto romane ka diçka më intime dhe universale që i frymëzon vërtetë: ëndrra e përjetshme e Andreas me shokë, e Henry-t, e Paul Baumerit dhe shokëve të tij 18 vjeçarë, për

një paqe, pushim, një mënyrë jetese në të cilën mos luftohet me njëri-tjetrin, me vuajtjet, me shtypjet shoqërore, me pasionet e liga, me rreziqet. Edhe pas sulmeve e betejave të ashpra, gjatë pushimeve të shkurtra këta të rinj janë plot ëndrra, Katczinsky i pyet me çfarë duan të merren pasi të mbarojë lufta. Aty fillojnë përgjigjet plot jetë e ngazëllim, që secili i kishte shfaqur që në bankat e shkollës së mesme!

Andrea ëndërron kthimin në atdhe dhe jetën në liri. Henry ëndërron kthimin në Amerikë bashkë me Ketrin-ën, por kjo ëndërr, thyhet në mes kur ajo vdes në spital, ai humb edhe një pjesë të identitetit të tij me vdekjen e Ketrin-ës. Secili nga romanet ka përmbylljen e tij pak a shumë të njëjtë. Gjithçka e qetë në frontin Perëndimor, mbyllet me kontrastin e frymëzuar midis së vërtetës barbare dhe artificiale, për shpëtimin e atdheut, kauzë artificiale që mori jetën e të rinjve, të cilët kishin dëshirat e zakonshme të jetojnë dhe realizojnë ëndrrat e tyre të jetës. Romani mbyllet me një kontrast që qëndron në ndjenjën e brendshme dhe theksohet vetëm pak në fund, në formë paradoksale, me vdekjen e personazhit kryesor Paul Baumer!

**Lufta si veprimtari absurde njerëzore:** Platoni thotë morali e përcakton politikën, Makiaveli thotë politika nuk ka asgjë të përbashkët me moralin, sot mund të thuhet politika e përcakton moralin. Ashtu siç i përzgjedh intelektualët në veprim Julien Benda autorët kanë përjetësuar dhe dëshmuar për krimet, humbjen e etikës së luftës dhe kotësinë e saj. Lufta është dukuria më e vjetër e jetës njerëzore. Ajo si e tillë ka qenë temë e autorëve antikë, që nga Iliada e deri sot. Ajo gjithashtu është temë debati e filozofëve të mëdhenj që nga antika e deri sot.

Njeriu si qenie shoqërore ka ndryshuar pak ose aspak që nga lashtësia. Aristoteli në veprën e tij Politika thotë: shkaqet që çojnë në revolucione dhe luftëra janë: dëshira për barazi, kur njerëzit mendojnë se janë të pabarabartë me të tjerët, ose dëshira për pabarazi dhe superioritet. *Inferiorët revoltohen në mënyrë që të jenë të barabartë, ndërsa të barabartët që të jenë superior.* (Aristoteli:127).

Autorët e pranojnë atë ‘ndiesi’ të fuqishme, të impulsit të njeriut, në natyrën e njeriut, të atij vitaliteti, në ndryshimet pa fund të gëzimit, dhimbjes, në ankthin, dramën e tragjedinë, trishtimin, triumfin e disfatën, që luftojnë në betejat e veta dhe shprehin dramën e vet. Humanisti frëng, Etjen de la Boesi të ultën si kategori estetike e përshkruan kështu: *mungesa e kontrollit të veprimeve të njeriut është tirani.* Ai thotë më tej „*Fatkeqësia më e madhe varet nga despotizmi i perandorit, kjo është relative për shkakun se asnjëherë nuk mund ta dimë se a do të jetë i kënaqur ai nqs do t'i ketë afër vetes të marrët sa herë që të dojë*“ (Borev:118).

Çështja kryesore është krijimi i një identiteti të ri, një bote të re! Personazhet e dinë në çfarë vorbulle janë dhe kjo ia bën të vështirë pushtuesit mënyrën e represionit. Identiteti këtu

shtresëzohet te kombi, te teksti, individi, te roli i shkrimtarit, qëllimi i të cilit është ta rrëfejë mekanizmin e ruajtjes së identitetit kombëtar e fetar, për më tepër ta zbardh të vërtetën e këtij identiteti. Në romane lexohet frika dhe urrejtja për sunduesin dhe për megallomaninë e të vetëve (*Asgjë e re në frontin Perëndimor*), nga fillimi deri në fund.

Qytete të zymta, njerëz të paushqyer, ecnin me këpucë të grisura, shtëpi e pallate të rrënuara nga bombardimet, spitalet e improvizuara me ushtarë të plagusur, të gjitha këto fotografi qëndrojnë para Baumerit, Frederic Henry-t, Andrea Borës. Këto detaje do të qëndrojnë gjatë në kujtesën e tyre me një mungesë të brendshme për tu bashkuar dhe për tu dhënë një kuptim e një shtytje për një shpëtim nga letargjia kolektive.

Paradise, his back bowed under carpets of mound and clay, was trying to describe his feeling that war is unimaginable and immeasurable in time and space. 'When you talk about the war, he said, meditating aloud, it's as though you didn't say anything. It stifles words. We are here, looking at this, like blind men' 'No, you can't imagine it' 'To begin with, how could anyone imagine this, without having been here?' 'You'd have to be mad!' whatever you tell them they won't believe you they just won't be able Nobody's going to know Just you. 'No, not even us! Not even us!' someone shouted 'we've seen too much of it!' 'And everything we've seen is too much. We're not built to take all this in.' (Stevenson, 2013:12).<sup>2</sup>

Këto pamje janë pjesë e çdo veprë letrare që rrëfen për të keqen e luftës, burgu, pamja e tmerrshme në fushën e luftës, në hendeqet pranë armikut. Romanet flasin për hapësirën dhe kohën kur ndodhin gjëra të tmerrshme. E keqja, dhuna, e ulëta, poshtërimi që si kategori estetike janë mishëruar me emrat e personazheve dhe titujt e romaneve. Por aty herë pas here ka edhe momente, gëzimi e humori, që vepron si shpresë dhe energji për të vazhduar më tej, që ndoshta fundi i luftës do të duket shpejt dhe ata do të kthehen në vendlindje për ti vënë në jetë ëndrrat e tyre rinore.

It is true that in the beginning men submit under constraint and by force; but those who come after them obey without regret and perform willingly what their predecessors had done because they had to. This is why men born under the yoke and then nourished and reared in

---

<sup>2</sup> Përkth. (Parajsa, kurrizi i tij u përkul në baltë dhe nën qilima të mykur, po përpiquej të përshkruante ndjenjën e tij se lufta ishte e paimagjinueshme dhe e pamatshme në kohë dhe hapësirë. "Kur flisni për luftën, tha ai, duke medituar me zë të lartë, është sikur të mos thoni asgjë. Ajo i mbyti fjalët. Ne jemi këtu, duke e parë këtë, si njerëz të verbër. " Jo, ju nuk mund ta imagjinoni " Për të filluar, si mund ta imagjinonte dikush këtë, pa qenë këtu? " Duhet të jeni të çmendur! ' ju thoni atyre se ata nuk do të besojnë se ju thjesht nuk do të jeni në gjendje askush nuk do të dijë vetëm ju. 'Jo, jo edhe ne! Jo edhe ne! "Dikush bërtiste" ne kemi parë shumë prej saj! "Dhe gjithçka që kemi parë është shumë. Nuk jemi të prerë për ta ndërmarrë gjithë këtë.)

slavery are content, without further effort, to live in their native circumstance, unaware of any other state or right, and considering as quite natural the condition into which they are born...the powerful influence of custom is in no respect more compelling than in this, namely, habituation to subjection (Étienne de La Boétie:21 )<sup>3</sup>.

Të rrallë kanë qenë udhëheqësit e mëdhenj, që kanë shkëlqyer me qeverisjen e tyre, si Charles de Gaulle, Fan Noli (vetëm gjashtë muaj), me idealizëm dhe imperativ moral deontologjik, ndërsa më të shumtë ata të frymëzuar nga drejtimi utilitar, ekspansionist, racist dhe të etur për famë e lavdi: Hitleri, Musolini, Stalini, etj. *In the unconscious we are still animals, and there is no reason to believe that any animal fears death with us human.* (Menninger, 1938:18)<sup>4</sup>.

### **Bibliografia**

- БОРЕВ, Јуриј (2008). *Естетика*, Скопје: Македонска реч.
- FRAJ, Northrop (1990). *Anatomia e kritikës*, Prishtinë: Rilindja.
- FREUD, Sigmund (1997). *Qëndresa dhe shtypja*, Tiranë: Fan Noli.
- FREUD, Sigmund (1997). *Ese mbi luftën dhe vdekjen*, Tiranë: Fan Noli.
- FROMM, Erich (2006). *Përtej robërisë së iluzioneve*, Tiranë: Fan Noli.
- GASSET, Jose Ortega y (2003). *Revolta e turmave*, Tiranë: Plejad.
- HEGEL, Georg Vilhelm Fridrih (1975). *Estetika III*, Beograd: Kultura.
- HEMINGWAY, Ernest (2003). *Për kë bie kambana*, Tiranë: Fan Noli.
- HEMINGWAY, Ernest (1998). *Lamtumirë armë*, Tiranë: Fan Noli.
- LA BOÉTIE, Étienne de (1975). *The politics of obedience: The discourse of voluntariness*, Alabama USA: Ludwig von Mises Institute.
- MARKO, Petro (2002). *Një natë dhe dy agime*, Tiranë: OMSCA.
- ПАЖО, Даниел-Анри (2002). *Опита и компаративна книжевност*, Скопје: Македонска книга.

---

<sup>3</sup> Përkth. Është e vërtetë se, në fillim njerëzit mbijetojnë nën forcën e kufizimeve; por ata që vijnë pas tyre binden pa u penduar dhe i kryejnë vullnetarisht detyrat që paraardhësit e tyre, ishin të obliguar sepse kështu duhej! Kjo është arsyeja pse meshkujt e lindur në skllavëri janë të kënaqur, pa u përpjekur më shumë që të jetojnë në kushte më të mira, se ata në cilat kanë lindur, ata janë të pavetëdijshëm për çdo të drejtë apo shtet tjetër, duke e konsideruar të natyrshme gjendjen në të cilën jetojnë. Ndikimi i fuqishëm i zakonit të të jetuarit në vazhdimësi, nuk është aspak më bindës se ky, pra jeta për tu nënshtruar

<sup>4</sup> Në të pavetëdijshmen jemi ende kafshë dhe nuk ka arsye për të besuar se cilado kafshë e ka frikë vdekjen si njerëzit.



PICHOIS, Claude & ROUSSEAU, André-Michel (1973). *Komparativna književnost*, Zagreb: Matica Hrvatska.

POZZATO, Maria Pia (2005). *Semiotika e tekstit*, Tiranë: SHBLU.

ПРИНС, Џералд (2001). *Речник на наратологија*, Скопје: Сигмапрес.

REMARQUE, Erich Maria (2016). *All quiet in the western front*, United Kingdom: Vintage Books.

TOLSTOY, Leo (2010). *The law of love and the law of violence*, Mineola New York: Dover Publications.

WEBER, Max (1999). *Vlast i politika*, Zagreb: Naklada Jesenski i Turk.